



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 shkurt 2022

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre
Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të
Specializuara**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave:
Sajmon Loz

Përmbajtja

I.	HISTORIKU	1
II.	STANDARDI I RISHIKIMIT	3
III.	ASPEKT PARAPRAK.....	3
IV.	DISKUTIM	5
A.	Pretendimet për gabime lidhur me zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare (Pikat (i), (ii)).....	7
1.	Nëse DZN-ja ka epërsi mbi legjislacionin shtetëror në kuadrin ligjor të Kosovës (Pika (i) pjesërisht)	7
(a)	Parashtrimet e palëve	7
(b)	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	8
2.	Nëse zbatimi i DZN-së në pajtim me Ligjin ndërhyr në parimin e ligjshmërisë (Pikat (i) pjesërisht, (ii))	11
(a)	Parashtrimet e palëve	11
(b)	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	13
B.	Pretendimet për gabime lidhur me ndërmarrjen kriminale të përbashkët (Pika (iii))	20
1.	Parashtrimet e palëve	20
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	21
C.	Pretendimet për gabime lidhur me juridiksionin lëndor mbi ndalimin arbitrar (Pika (iv))	25
1.	Parashtrimet e palëve	25
2.	Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit.....	26
V.	VENDIM.....	29

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim apelin e parashtruar më 9 nëntor 2021 nga Pjetër Shala (përkatësisht, “Shala” ose “i akuzuari” ose “Mbrojtja”, dhe “Apeli”)² kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara (“Vendimi i Apeluar”).³ Më 29 nëntor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi përgjigjen ndaj Apelit (“Përgjigja”).⁴ Më 9 dhjetor 2021, Shala parashtroi kundërpërgjigjen e vet (“Kundërpërgjigja”).⁵

I. HISTORIKU

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake,⁶ ZPS-ja paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.⁷ Më 1 nëntor 2021, ZPS-ja paraqiti

¹ F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 10 Nëntor 2021.

² F00003, Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 9 nëntor 2021 (“Apeli”). Paneli i Gjykatës së Apelit e shtyu, me vendim të datës 28 tetor 2021, afatin për parashtrimin e Apelit (shih F00002, Vendim mbi Kërkesën e Shalës për Ndryshim Afati, 28 tetor 2021) dhe, me vendim të datës 17 nëntor 2021, për parashtrimin e përgjigjes dhe kundërpërgjigjes në lidhje me të (shih F00007, Vendim mbi Kërkesat e Palëve për Ndryshimin e Afateve, 17 nëntor 2021).

³ F00088, Vendim mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 18 tetor 2021 (“Vendimi i Apeluar”).

⁴ F00008, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 29 nëntor 2021 (“Përgjigja”).

⁵ F00009, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 9 dhjetor 2021 (“Kundërpërgjigja”).

⁶ F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 6 maj 2021 (versionet konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* u protokolluan më 12 qershor 2020) (“Vendimi i Konfirmimit”).

⁷ F00010/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, 19 qershor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar konfidenciale më 29 prill 2021). Shih edhe F00016/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Versioneve me më pak Redaktime dhe të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar dhe të Kërkesave të lidhura me Të, 31 mars 2021 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar publike më 15 prill 2021).

Aktakuzën në fuqi, në bazë të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake (“Aktakuza”).⁸

2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit⁹ dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,¹⁰ Shala u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).¹¹

3. Më 15 prill 2021, Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.¹²

4. Më 12 korrik 2021, në vijim të një urdhri gojor për ndryshimin e afatit,¹³ Shala dorëzoi një mocion paraprak që ngrinte kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara.¹⁴

⁸ Shih F00098/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar, 1 nëntor 2021 (konfidencial); F00107/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Korrigjuar, 16 nëntor 2021 (“Aktakuza”). Shih edhe F00089/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 18 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 tetor 2021), para. 118.

⁹ F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit, 6 maj 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020).

¹⁰ F00008/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Pjetër Shala, 15 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020, riklasifikuar si konfidencial më 19 tetor 2021). Shih edhe F00008/A02/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 15 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 12 qershor 2020).

¹¹ F00013, Njoftim i Arrestimit të Pjetër Shalës sipas rregullës 55(4), 16 mars 2021 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar publik më 29 prill 2021).

¹² F00019/RED, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit, 26 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 prill 2021).

¹³ Transkripti i datës 21 qershor 2021, f. 62, rreshtat 12-19.

¹⁴ F00054, Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së, 12 korrik 2021 (“Mocioni Paraprak”).

5. Më 6 shtator 2021, në vijim të vendimit për ndryshimin e mëtejshëm të afateve të zbatueshme¹⁵ dhe të vendimit për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve,¹⁶ ZPS-ja dorëzoi përgjigjen ndaj Mocionit Paraprak.¹⁷

6. Më 25 shtator 2021, në vijim të Vendimit për Ndryshimin e Afatit dhe të urdhrin gojor për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve,¹⁸ Shala dorëzoi kundërpërgjigjen.¹⁹

7. Më 18 tetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Apeluar, ku, ndër të tjera, rrëzonte Mocionin Paraprak për aq sa kundërshtonte juridiksionin e Dhomave të Specializuara.²⁰

II. STANDARDI I RISHIKIMIT

8. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e rishikimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e vet të parë dhe të zbatuar më pas.²¹

III. ASPEKT PARAPRAK

9. Shala kërkon shtim prej 1.210 fjalësh të numrit të lejuar të fjalëve për Kundërpërgjigjen për shkak të rëndësisë së çështjeve të ngritura.²² Paneli vëren se neni 46(3) i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para

¹⁵ F00052, Vendim mbi Kërkesën për Ndryshim të Afatit, 5 korrik 2021 (“Vendimi për Ndryshimin e Afatit”).

¹⁶ F00067, Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Tejkalinin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 3 shtator 2021 (“Vendimi për Tejkalinin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Përgjigjen ndaj Mocionit Paraprak”).

¹⁷ F00071, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së z. Shala që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së, 6 shtator 2021 (“Përgjigja ndaj Mocionit Paraprak”).

¹⁸ Transkript i datës 23 shtator 2021, f. 101, rreshti 19 – f. 102, rreshti 7 (“Urdhri për Tejkalinin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjen Paraprake”).

¹⁹ F00084, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit Paraprak të Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së, 25 shtator 2021 (“Kundërpërgjigja Paraprake”).

²⁰ Vendimi i Apeluar, para. 79, 89, 97, 103-104.

²¹ KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 4-14. Shih, p.sh., edhe F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2021), para. 5.

²² Kundërpërgjigja, poshtëshënimi 1. Shala duket se e ka tejkualuar numrin e lejuar të fjalëve për Kundërpërgjigjen e vet me 1.207 fjalë.

Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)²³ përcakton që apeli i ndërmjetëm kundër vendimit mbi mocionin paraprak të parashtruar në bazë të rregullës 97(3) të Rregullores dhe përgjigjja ndaj tij nuk duhet të jenë më shumë se 9.000 fjalë dhe se kundërpërgjigjja ndaj një përgjigjeje të tillë nuk duhet të jetë më shumë se 3.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton që pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë, paraprakisht dhe duke lejuar kohë të mjaftueshme, tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve në rast se vërtetojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të veçanta.

10. Paneli vëren se Shala e dorëzoi kërkesën për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve në kuadër të Kundërpërgjigjes, jo “paraprakisht dhe duke lejuar kohë të mjaftueshme” siç përcakton Udhëzuesi i Punës. Paneli vëren më tej se Shala nuk argumenton konkretisht se ekziston një arsye e vlefshme për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve që do të përbënte rrethana të veçanta, me përjashtim të parashtrimit në një poshtëshënim se ky tejkalim “është i nevojshëm”.²⁴

11. Gjithashtu, Paneli mban parasysh se Përgjigjja nuk e tejkalon numrin e lejuar të fjalëve. Megjithatë, Paneli mban parasysh edhe se ka miratuar tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve në lidhje me parashtrimet e protokolluara mbi kundërshtimet juridikionale në çështje të tjera gjyqësore, për shkak të rëndësisë së këtyre apeleve dhe të interesit të Panelit për të marrë parashtrime më të hollësishme se sa do të lejohej normalisht.²⁵ Gjithashtu, Paneli vëren se numri i fjalëve i Apelit është shumë më i

²³ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

²⁴ Shih Kundërpërgjigjen, poshtëshënimi 1.

²⁵ Shih, p.sh., KSC-BC-2020-06, F00024, Vendim mbi Kërkesën e Selimit për Ndryshimin e Numrit të lejuar të Fjalëve, 14 tetor 2021; KSC-BC-2020-06, F00017, Vendim mbi Kërkesën për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 24 shtator 2021; KSC-BC-2020-06, F00009, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të lejuar të Fjalëve, 19 gusht 2021, në veçanti para. 5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi edhe tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve për Përgjigjen ndaj Mocionit Paraprak dhe për Kundërpërgjigjen Paraprake. Shih Vendimin për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Përgjigjen ndaj Mocionit Paraprak; Urdhrin për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjen Paraprake.

vogël se numri i lejuar i fjalëve dhe vëren se tejkالمي i kërkuar i numrit të lejuar të fjalëve është i arsyeshëm.

12. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se, pavarësisht nga mangësitë e ndjeshme të kërkesës për tejkالمي të numrit të lejuar të fjalëve, që identifikohen më lart,²⁶ ekziston arsye e vlefshme që përbën rrethana të veçanta dhe se tejkالمي i numrit të fjalëve përlligjet në mënyrë absolutisht të veçantë në rrethanat e këtij Apeli i cili ka të bëjë me aspekte juridikionale komplekse. Sidoqoftë, Paneli e nxit Shalën, dhe palët në përgjithësi, të parashikojnë dhe të dorëzojnë duke lejuar kohë të mjaftueshme kërkesa të ngjashme në të ardhmen.

IV. DISKUTIM

13. Paneli vëren që në fillim parashtrimin e ZPS-së se argumentet e Shalës mbi zbatueshmërinë e të drejtës zakonore ndërkombëtare ("DZN"), ndërmarrjen kriminale të përbashkët ("NKP") dhe ndalimin arbitrar përmbajnë "mbivendosje të konsiderueshme" dhe duhet trajtuar në atë mënyrë që përputhet me qasjen e ndjekur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në kuptimin që zbatueshmëria e DZN-së, prapaveprimi, NKP-ja dhe ndalimi arbitrar të trajtohen veçmas.²⁷ Në kundërpërgjigje, Shala parashtron se pikat e apelit të tij duhet trajtuar siç paraqiten dhe jo siç i interpreton ZPS-ja, sepse zbatimi i DZN-së në mënyrën e përshkruar në Vendimin e Apeluar është i gabuar për disa arsye, secila prej të cilave ka të bëjë me të drejtat e ndryshme themelore të të akuzuarit dhe janë shtjelluar si pika të veçanta të apelit.²⁸

14. Sipas mendimit të Panelit, në qoftë se DZN-ja është e zbatueshme në Dhomat e Specializuara dhe nëse ka epërsi mbi legjislacionin shtetëror, atëherë do të mjaftonte për njohjen e juridiksionit të Dhomave të Specializuara në lidhje me NKP-në dhe ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar të cilat ishin të

²⁶ Shih më lart, para. 10.

²⁷ Përgjigja, para. 9, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 80.

²⁸ Kundërpërgjigja, para. 3, ku i referohet Përgjigjes, para. 9.

përcaktuara, përkatësisht, si formë përgjegjësie dhe krim në DZN në periudhën përkatëse dhe përmbushin kriteret e parimit të ligjshmërisë, përfshirë edhe se ishin të disponueshme dhe të parashikueshme për të akuzuarin. Pra, çështja nëse DZN-ja është apo nuk është e zbatueshme dhe nëse ka apo nuk ka epërsi mbi të drejtën e brendshme dhe nëse njohja e DZN-së në Ligj është apo jo në përputhje me parimin e ligjshmërisë dallon nga çështja nëse kanë apo nuk kanë Dhomat e Specializuara juridiksion në lidhje me NKP-në dhe ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar. Paneli vëren se këtë gjë e pasqyrojnë titujt e pikave të apelit të Shalës.²⁹ Rrjedhimisht, Paneli nuk konstaton asnjë gabim në qasjen e ndjekur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake³⁰ dhe do të ndjekë të njëjtën qasje.

15. Gjithashtu, Paneli vëren se ka nxjerrë edhe më parë një vendim mbi aspektet kryesore të ngritura në katër pikat e apelit të paraqitura nga Shala, që janë: (i) epërsia e DZN-së mbi legjislacionin shtetëror;³¹ (ii) ndërhyrja e Ligjit në parimin e mosprapaveprueshmërisë sipas nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) dhe dispozitave analoge të Kushtetutës së Kosovës;³² (iii) përfshirja e formës së parë dhe formës së tretë të NKP-së në nenin 16(1) të Ligjit;³³ dhe (iv) juridiksioni i Dhomave të Specializuara mbi ndalimin arbitrar në një konflikt të

²⁹ Titujt e pikave të apelit të Shalës janë: (i) “Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që i dha epërsi pa rezerva DZN-së dhe interpretimoi kuadrin të zbatueshëm legjislativ në shkelje të të drejtave themelore të z. Shala”; (ii) “Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabuar që nuk njohu ndërhyrjen në parimin e mosprapaveprueshmërisë dhe shkeljen e nenit 7 të KEDNJ-së dhe garancinë e njëjtë të Kushtetutës së Kosovës”; (iii) “Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se përgjegjësia sipas formës së parë dhe të tretë të NKP-së është e përfshirë në nenin 16(1)(a) të Ligjit”; dhe (iv) “Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri gabim juridik që konstatoi se ndalimi arbitrar në [konflikt të armatosur jondërkombëtar] bën pjesë në juridiksionin [e Dhomave të Specializuara]”. Shih edhe Apelin, para. 4.

³⁰ Vendimi i Apeluar, para. 80.

³¹ Krahaso Apelin, para. 7-13 *me* KSC-BC-2020-06, F00030, Vendimin mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, 23 dhjetor 2021 (“Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët”), para. 22-29, 52-59.

³² Krahaso Apelin, para. 14-19 *me* Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 35-40.

³³ Krahaso Apelin, para. 20-22 *me* Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 135-144. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 162-172, 186-196, 211-224.

armatosur jondërkombëtar.³⁴ Në këtë aspekt, Paneli vëren se, në interes të sigurisë dhe parashikueshmërisë juridike, nga një panel i apelit do të pritej të ndiqte vendimet e tij të mëparshme dhe do të duhej të devijonte prej tyre vetëm për arsye bindëse në interes të drejtësisë.³⁵

A. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME ZBATUESHMËRINË E TË DREJTËS ZAKONORE NDËRKOMBËTARE (PIKAT (I), (II))

1. Nëse DZN-ja ka epërsi mbi legjislacionin shtetëror në kuadrin ligjor të Kosovës (Pika (i) pjesërisht)

(a) Parashtrimet e palëve

16. Në pikën e parë të apelit, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke i dhënë epërsi “pa rezerva” DZN-së mbi legjislacionin shtetëror pavarësisht nga gjuha e përdorur shprehimisht në dispozitat përkatëse dhe nga jurisprudenca e detyrueshme që kërkon të kundërtën, duke shkelur kështu të drejtat e tij themelore.³⁶ Sipas Shalës, konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake shkel epërsinë e Kushtetutës sipas nenit 16 të Kushtetutës dhe nuk pajton mospërputhshmërinë midis nenit 3(2)(d) të Ligjit dhe nenit 19(2) të Kushtetutës së Kosovës.³⁷ Gjithashtu, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk arsyetoi mjaftueshëm përfundimin e tij se Ligji mund t’i jepte në mënyrë të ligjshme parësi DZN-së.³⁸ Shala argumenton edhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk trajtoi parashtrimet e tij se Dhomat e Specializuara si gjykatë e brendshme duhet të

³⁴ Krahaso Apelin, para. 23-24 *me* Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 87-89. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 94-102, 106-111.

³⁵ Shih ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Semanza*, ICTR-97-23-A, Decision, 31 May 2000, para. 92; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Aleksovski*, IT-95-14/1-A, Judgement, 24 March 2000, para. 107-110 (me të cilin, Dhomat e Apelit të TPNJ-së shpreheshin ndër të tjera se rastet kur arsye bindëse në interes të drejtësisë do të kërkonin shmangie nga vendimet e apelit do të ishin rastet kur vendimet janë marrë në bazë të një parimi të gabuar juridik apo kur gjykatësit kanë qenë të keqinformuar lidhur me të drejtën e zbatueshme).

³⁶ Apeli, para. 3-4(i), 7. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 4.

³⁷ Apeli, para. 8, 10. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 12, 23.

³⁸ Apeli, para. 8. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 15-16.

veprojnë në përputhje me legjislacionin shtetëror, duke cenuar kështu cilësinë e kuadrit të zbatueshëm ligjor dhe duke krijuar paqartësi lidhur me peshën që duhet dhënë statuteve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”), Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”) dhe Mekanizimit Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë.³⁹ Së fundi, Shala argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1974 (“RSFJ” dhe “Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974”) dhe Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 nuk e kufizojnë juridiksionin e DHS-së⁴⁰ dhe kur shpërfill aktgjykimet me të cilat Gjykata Supreme e Kosovës shprehej se gjatë kohës që ka lidhje me akuzat zbatohet Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974.⁴¹

17. ZPS-ja përgjigjet se Ligji i jep DZN-së zbatim të drejtpërdrejtë në Dhomat e Specializuara⁴² dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e njohu rolin e përshtatshëm të Kushtetutës së Kosovës dhe mori në konsideratë argumentet përkatëse të Mbrojtjes.⁴³ Sipas ZPS-së, dispozitat ligjore të zbatueshme nuk krijojnë asnjë paqartësi pavarësisht nga natyra e Dhomave të Specializuara.⁴⁴

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

18. Paneli vëren se, edhe pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon se Ligji është objekt i parimeve dhe garancive të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës,⁴⁵ ai nuk shqyrtoi konkretisht nëse njohja e përparësisë së DZN-së në Ligj është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, pavarësisht se i kërkohej të bënte një shqyrtim

³⁹ Apeli, para. 8, 9, 12-13. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 17.

⁴⁰ Apeli, para. 10; Kundërpërgjigjja, para. 6, 8.

⁴¹ Apeli, para. 10; Kundërpërgjigjja, para. 7-8. Shih edhe Apelin, para. 15; Kundërpërgjigjen, para. 6.

⁴² Përgjigjja, para. 10. Shih edhe Përgjigjen, para. 23 (ku parashtrohet se del qartë nga Ligji se ligjvënësit kosovarë i kuptonin krimet dhe format e përgjegjësisë në nenet 14 dhe 16 të Ligjit si “norma juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”).

⁴³ Përgjigjja, para. 13-16, 19.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 17.

⁴⁵ Vendimi i Apeluar, para. 65, 77, 82.

të tillë.⁴⁶ Megjithatë, Paneli rikujton konstatimin e tij të mëparshëm se DZN-ja ka parësi mbi legjislacionin shtetëror në kuadrin ligjor të Kosovës dhe se kjo është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.⁴⁷ Paneli rikujton konkretisht se, në dallim nga argumentet e Shalës,⁴⁸ nuk ka asnjë kundërthënie midis gjuhës së Ligjit, i cili në nenet 3(2)(d) dhe 12 përmend “të drejtën zakonore ndërkombëtare”, dhe gjuhës së Kushtetutës së Kosovës, e cila në nenin 19(2) përdor termin “normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare”, meqë DZN-ja është e detyrueshme për të gjitha shtetet.⁴⁹ Paneli rikujton më tej se, duke marrë parasysh sa më lart, nuk ka bazë ligjore për ekzistencën e një dispozite përkatëse në legjislacionin shtetëror e zbatueshme në periudhën e krimeve të pretenduara.⁵⁰ Sipas mendimit të Panelit, konstatimi se DZN-ja ka përparësi mbi legjislacionin e Kosovës, sipas nenit 19(2) të Kushtetutës së Kosovës, nuk përbën shkelje të nenit 16 të Kushtetutës së Kosovës i cili flet për raportin midis Kushtetutës, nga njëra anë, dhe ligjeve dhe akteve të tjera juridike, nga ana tjetër.⁵¹

19. Paneli vëren se është i qartë kushti që Ligji të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës⁵² dhe me burimet e së drejtës së zbatueshme në Dhomat e Specializuara, përfshirë rolin që luan jurisprudenca e tribunalëve të posaçëm në përcaktimin e DZN-së së zbatueshme.⁵³ Paneli është i mendimit se nuk është kategorizimi i Dhomave të Specializuara si një lloj i veçantë gjykate ai që përcakton të drejtën e zbatueshme, por

⁴⁶ Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 22, ku i referohet nenit 16(1) të Kushtetutës së Kosovës; nenit 3(2)(a) të Ligjit; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë*, KO/43/19, Aktgjykim, 27 qershor 2019, para. 68-69.

⁴⁷ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 23-24.

⁴⁸ Shih Apelin, para. 7, 10; Kundërpërgjigjen, para. 12.

⁴⁹ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 23-24.

⁵⁰ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 24.

⁵¹ Paneli pranon se Ligji duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Shih, më lart, poshtëshënimin 46 dhe, më poshtë, poshtëshënimin 52.

⁵² Shih nenin 162(2) të Kushtetutës së Kosovës; neni 3(2) i Ligjit.

⁵³ Shih nenin 3(2) dhe (3) të Ligjit. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *“Thaçi dhe të tjerët”*, para. 152.

vetë Ligji. Rrjedhimisht, Paneli pajtohet me konstatimin e Gjykatësi i Procedurës Paraprake se “kategorizimi i një gjykate si vendore, ndërkombëtare, hibride apo ndryshe nuk përcakton kornizën ligjore”.⁵⁴

20. Gjithashtu, Paneli rikujton se Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 nuk e kufizon juridiksionin e Dhomave të Specializuara, sepse, ndër të tjera, Kushtetuta e Kosovës e miratuar në vitin 2008 zëvendësoi çdo kushtetutë të zbatueshme më parë në territorin e Kosovës dhe Dhomat e Specializuara kanë detyrimin të respektojnë vetëm mbrojtjet e mishëruara në të.⁵⁵ Pasi ka konstatuar se DZN-ja ka përparësi mbi legjislacionin e vendor dhe duke mbajtur parasysh se kjo është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës,⁵⁶ Paneli gjithashtu nuk konstaton gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 nuk e kufizon juridiksionin e Dhomave të Specializuara.⁵⁷ Gjithashtu, Paneli rikujton se aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës të cilave u referohet Shala në mbështetje të argumentit të tij se DZN-ja nuk është e zbatueshme për ngjarjet që pretendohet se kanë ndodhur në vitin

⁵⁴ Shih Vendimi i Apeluar, para. 82. Contra Apeli, para. 8; Kundërpërgjigjja, para. 17.

⁵⁵ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 25-26. Në çdo rast, Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974, nën titullin “Parimet themelore”, zotohet të respektojë “normat përgjithësisht të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare”, ku përfshihej edhe DZN-ja, si edhe të përmbushë angazhimet ndërkombëtare kundrejt organizatave ndërkombëtare në të cilat bënte pjesë RSFJ-ja, ku përfshihej edhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (“KNDKCP”). Shih Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, Parimi Themelor VII: “Në marrëdhëniet ndërkombëtare [RSFJ] respekton parimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përmbush angazhimet ndërkombëtare dhe merr pjesë aktive në veprimtaritë e organizatave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar [...] Për t’i vënë në jetë këto parime [RSFJ] bën përpjekje: [...] për respektimin e normave përgjithësisht të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare [...]” (theksi është shtuar këtu).

⁵⁶ Shih më lart, para. 18. Shih edhe Vendimin e Apeluar, para. 82.

⁵⁷ Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 26 (ku Paneli vendosi edhe se kjo përputhet me zbatimin e kufizuar të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976, sipas nenit 15(1) të Ligjit, “në varësi të nenit 12 të Ligjit”).

1999⁵⁸, nuk kanë lidhje me Dhomat e Specializuara, sepse kanë të bëjnë me një kornizë të ndryshme kushtetuese.⁵⁹

21. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Shala nuk ka demonstruar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se DZN-ja ka përparësi mbi legjislacionin vendor në kornizën ligjore të Kosovës. Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit e rrëzon pjesën përkatëse të Pikës (i) të Apelit të Shalës.

2. Nëse zbatimi i DZN-së në pajtim me Ligjin ndërhyt në parimin e ligjshmërisë (Pikat (i) pjesërisht, (ii))

(a) Parashtrimet e palëve

22. Në një pjesë të pikës së parë të Apelit dhe në pikën e dytë të Apelit, Shala argumenton se interpretimi që i ka bërë Gjykatësi i Procedurës Paraprake kornizës ligjore është “palejueshmërisht teleologjik” dhe, si i tillë, përbën shkelje të neneve 6 dhe 7 të KEDNJ-së.⁶⁰ Shala parashtron konkretisht se analiza që bëri Gjykatësi i Procedurës Paraprake është “qartazi e paarsyeshme” sepse mohon “karakterin e dukshëm prapaveprues” të Ligjit dhe nuk merr në konsideratë parashtrimet e Shalës lidhur me qartësinë e të drejtës përkatëse.⁶¹ Sipas Shalës, kjo shkel kriteret e “cilësisë së ligjit” sa i takon disponueshmërisë, parashikueshmërisë dhe saktësisë që kërkon Kushtetuta e Kosovës dhe KEDNJ-ja.⁶² Shala parashtron gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se hyrja në fuqi e legjislacionit vendor për sjellje të kryera para penalizimit të tyre nuk e shkel parimin e ligjshmërisë, sidomos

⁵⁸ Apeli, para. 10, ku përmendet Kosova, Gjykata Supreme, “Gashi dhe të tjerët”, AP-KZ 139/2004, Aktgjykim, 21 korrik 2005 (“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 21 korrik 2005”), f. 6, 12, Kosova, Gjykata Supreme, “Besoviq”, AP-KZ 80/2004, Aktgjykim, 7 shtator 2004 (“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 7 shtator 2004”), f. 18-19. Shih edhe Apeli, para. 7.

⁵⁹ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 27, ku përmendet, ndër të tjera, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 21 korrik 2005, f. 8; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 7 shtator 2004, f. 18-19. Shih edhe Vendimin e Apeluar, para. 83.

⁶⁰ Apeli, para. 9. Shih edhe Apelin, para. 25; Kundërpërgjigjen, para. 17.

⁶¹ Apeli, para. 9, 15. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 12-13, 18.

⁶² Apeli, para. 9, 15. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 5, 22.

ngaqë neni 7 i KEDNJ-së ndalon në mënyrë të pakushtëzuar zbatimin prapaveprues të së drejtës penale kur është në dëm të të akuzuarit.⁶³ Sipas Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk zbatoi kriterin e saktë sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të njeriut (“GJEDNJ”), që lejon ndjekjen penale në bazë të së drejtës ndërkombëtare vetëm në lidhje me sjelljen “e paligjshme në mënyrë flagrante”, natyra penale e së cilës është “dukshëm” e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin.⁶⁴ Shala argumenton gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se neni 12 i Ligjit është në pajtim me parimin e mosprapaveprueshmërisë por pa pranuar natyrën e tejkaluar të nenit 7(2) të KEDNJ-së.⁶⁵ Së fundi, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk vlerësoi se cila kornizë ligjore do të duhej të zbatohet në përputhje me nenin 7 të KEDNJ-së dhe nuk shpjegoi se si parimi i ligjshmërisë mund të lejojë një kornizë më pak të favorshme, sidomos në lidhje me akuzat për ndalim arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe për ndërmarrje kriminale të përbashkët.⁶⁶

23. ZPS-ja përgjigjet se nuk ka asnjë problem të zbatimit prapaveprues, duke qenë se DZN-ja zbatohet në periudhën e krimeve të pretenduara.⁶⁷ Sipas ZPS-së, neni 12 i Ligjit nuk lë vend për paqartësi sa i takon rolit të DZN-së në Dhomat e Specializuara dhe është në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës, përfshirë edhe parimin e mosprapaveprueshmërisë, nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 15 të KNDCP-së, si edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së.⁶⁸ Sipas ZPS-së, është i saktë përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ndëshkueshmëria e sjelljes që përbën krim sipas DZN-së ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin⁶⁹ dhe është i pabazë pretendimi i Shalës se interpretimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake është

⁶³ Apeli, para. 4(ii), 10, 14; Kundërpërgjigjja, para. 9, 14, 20-23. Shih edhe Apelin, para. 3, 15.

⁶⁴ Apeli, para. 16-18; Kundërpërgjigjja, para. 24.

⁶⁵ Apeli, para. 12, 19. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 19, 26.

⁶⁶ Apeli, para. 11-12; Kundërpërgjigjja, para. 9-13, 25.

⁶⁷ Përgjigjja, para. 11.

⁶⁸ Përgjigjja, para. 12, 20-24, 26-28. Shih edhe Përgjigjen, para. 23.

⁶⁹ Përgjigjja, para. 24. Shih edhe Përgjigjen, para. 17.

“palejueshmërisht teleologjik ”.⁷⁰ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Dhomat e Specializuara nuk funksionojnë sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 dhe vendimet e marra sipas Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut në të cilat zbatohet Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 nuk ndikojnë në këtë çështje gjyqësore.⁷¹ ZPS-ja së fundi argumenton se nuk ndikohet parimi *lex mitior* sepse Dhomat e Specializuara kanë detyrimin të zbatojnë DZN-në, pra nuk ka një tërësi legjislacioni të ndryshuar dhe detyrues për qëllime krahasimi, dhe se argumentet e Mbrojtjes duhen rrëzuar sepse u ngritën vetëm në Kundërpërgjigjen Paraprake.⁷²

(b) Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

24. Paneli rikujton konstatimin e vet se neni 12 i Ligjit nuk e shkel parimin e ligjshmërisë sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe Kushtetutës së Kosovës.⁷³ Sipas mendimit të Panelit, neni 12 i Ligjit nuk përbën problem prapaveprueshmërie, sepse, siç ka vërejtur Gjykatësi i Procedurës Paraprake, juridiksioni lëndor i Dhomave të Specializuara përvijohet nga DZN-ja e cila zbatohet në periudhën e kryerjes së krimeve të pretenduara, para hyrjes në fuqi të Ligjit.⁷⁴

25. Paneli vëren se Shala nuk mbështet me fakte se çfarë nënkupton me karakterizimin e nenit 7(2) të KEDNJ-së si “të tejkaluar”.⁷⁵ Paneli kupton se argumenti i tij ka të bëjë me faktin se kjo dispozitë është miratuar për të siguruar vlefshmërinë e aktgjykimeve të Tribunalit të Nurembergut.⁷⁶ Në këtë aspekt, Paneli rikujton se gjykon

⁷⁰ Përgjigja, para. 18.

⁷¹ Përgjigja, para. 25-26.

⁷² Përgjigja, poshtëshënimi 18.

⁷³ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 37-40.

⁷⁴ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 38, ku referohen nenet 12, 13(1) dhe 14(1) të Ligjit. Shih edhe Vendimin e Apeluar, para. 85.

⁷⁵ Shih Apelin, para. 12, 19.

⁷⁶ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 38, në të cilit i referohet Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, Puna Përgatitore për Nenin 7 të Konventës Evropiane të Njeriut, 21 maj 1957, f. 4-5, 7, 10 (ku Komiteti i Ekspertëve për të Drejtat e Njeriut raportonte se parimi i mishëruar në nenin 7 të KEDNJ-së “nuk prek ligjet të cilat u miratuan, në rrethana shumë të veçanta në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, për të luftuar krimet e luftës, tradhtinë dhe kolaboracionizmin me armikun” (theksi është shtuar këtu)); GJEDNJ, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina*, nos. 2312/08 and 34179/08, Judgment, 18 July 2013 (“*Maktouf and Damjanović v. Bosnia*

se referimi ndaj nenit 7(2) të KEDNJ-së dhe nenit 15(2) të KNDCP-së në nenin 12 të Ligjit kërkon të theksojë natyrën e veçantë të krimeve bazë ndërkombëtare, që janë pasqyruar vetëm së fundmi në legjislacionin e kodifikuar vendor.⁷⁷ Thelbi i kësaj reflektohet në mënyrë të ngjashme në nenin 33(1) të Kushtetutës së Kosovës, që përmendet edhe në nenin 12 i Ligjit dhe ku përcaktohet se “askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”.⁷⁸ Siç vërehet, neni 12 i Ligjit nuk përbën përjashtim nga parimi i prapaveprueshmërisë që do të kërkonte justifikim të referimit ndaj nenit 7(2) të KEDNJ-së dhe nenit 15(2) të KNDCP-së.⁷⁹ Gjithashtu, Paneli rikujton se, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, KEDNJ-ja dhe KNDCP-ja orientojnë interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të cilat i garanton Kushtetuta e Kosovës, përfshirë parimin e ligjshmërisë, dhe rrjedhimisht nuk konstaton asnjë gabim në konstatimin Gjykatësit të Procedurës Paraprake se neni 7 i KEDNJ-së dhe neni 15 i KNDCP-së zbatohen në tërësinë e tyre për nenin 12 të Ligjit.⁸⁰ Duke mbajtur këtë parasysh, Paneli konstaton gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi

and Herzegovina Judgment”), para. 72. Parimi i ligjshmërisë bën pjesë në të drejtat e patjetërsueshme. Shih nenin 56(2) të Kushtetutës së Kosovës; nenin 15(2) të KEDNJ-së; nenin 4(2) të KNDCP-së.

⁷⁷ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39.

⁷⁸ Edhe *Dhoma e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (“DHJGJK”)* përfshinin një përjashtim për krimet ndërkombëtare në formulimin që i bënë parimit të ligjshmërisë në të drejtën vendore. Shih *ECCC/DHJGJK, Ieng Sary et al., 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ, Decision on Ieng Sary’s Appeal against the Closing Order, 11 April 2011 (“Ieng Sary Appeal Decision”)*, para. 214.

⁷⁹ Shih edhe *Kosova, Gjykata Supreme, “Kolasinac”, AP-KZ 139/2003, Aktgjykim, 5 gusht 2004 (“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 5 gusht 2004”)*, p. 33, poshtëshënimi 72 (ku Gjykata Supreme e Kosovës pranonte se prapaveprueshmëria në lidhje me përgjegjësinë si epror nuk ndalohej nga neni 7 i KEDNJ-së, pavarësisht nga fakti se kjo formë e përgjegjësisë penale u përfshi në legjislacionin e Kosovës pas ngjarjeve që pretendohet se kanë ndodhur më 1998 dhe 1999).

⁸⁰ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 36, ku i referohet, ndër të tjera, Aktgjykimit *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina Judgment*, para. 72 (ku GJEDNJ-ja shprehej se dy paragrafët e nenit 7 të KEDNJ-së janë të ndërlidhur dhe duhet interpretuar në mënyrë të përputhshme). Shih Vendimin e Apeluar, para. 85.

argumentet përkatëse të parashtruara nga Shala dhe dha arsyetim adekuat të konstatimit të tij.⁸¹

26. Paneli do të trajtojë tani parashtrimin e Shalës se, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përfshirja në legjislacionin vendor të një norme ndërkombëtare që përkufizon një vepër penale, është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e përputhshmërisë së proceseve penale me nenin 7 të KEDNJ-së.⁸² Sipas mendimit të Panelit, Shala i shtrembëron aktgjykimet e GJEDNJ-së të cilave u referohet.⁸³ Gjithashtu, në të njëjtat aktgjykime, GJEDNJ-ja konstatoi se është e pranuar gjerësisht se termi “e drejtë” në nenin 7(1) të KEDNJ-së përfshin si të drejtën e kodifikuar ashtu edhe atë të pakodifikuar,⁸⁴ duke pranuar kështu qartësisht DZN-në si burim penalizimi. Paneli vëren se neni 33(1) i Kushtetutës së Kosovës e konfirmon parimin e ligjshmërisë, në mënyrë të ngjashme me nenin 7(1) të KEDNJ-së, ku vepra që përbën vepër penale është paraparë në “të drejtën”⁸⁵ dhe shprehimisht përcakton se veprat të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, “sipas së drejtës ndërkombëtare”, përbënin gjenocid,

⁸¹ Contra Apeli, para. 19.

⁸² Shih Apelin, para. 10, ku i referohet GJEDNJ, *Korbely v. Hungary*, no. 9174/02, Judgment, 19 September 2008 (“*Korbely v. Hungary Judgment*”), para. 74-75; Kundërpërgjigjen, para. 22, ku i referohet GJEDNJ, *Kononov v. Latvia*, no. 36376/04, Judgment, 17 May 2010 (“*Kononov v. Latvia Judgment*”), para. 214 (ku parashtrohet se “GJEDNJ-ja kërkon që përputhshmëria me nenin 7 të vlerësohet duke shqyrtuar nëse ka ‘bazë ligjore mjaftueshmërisht të qartë dhe bashkëkohore për krimet konkrete të luftës’”).

⁸³ Në aktgjykimin e parë, GJEDNJ-ja vetëm sa shqyrtoi nëse Konventat e Gjenevës ishin të disponueshme për të akuzuarit në bazë të faktit se teksti i tyre nuk ishte i përfshirë në legjislacionin vendor që i proklamonte dhe arriti në përfundimin se ishin të disponueshme. Shih *Korbely v. Hungary Judgment*, para. 75. Në aktgjykimin e dytë, GJEDNJ-ja shqyrtoi nëse kishte bazë ligjore mjaftueshmërisht të qartë dhe bashkëkohore për krimet konkrete të luftës dhe arriti në përfundimin se “kishte një bazë ligjore mjaftueshmërisht të qartë, po të kihet parasysh gjendja e së drejtës ndërkombëtare në vitin 1944”. Shih *Kononov v. Latvia Judgment*, para. 214, 227 (theksi është shtuar këtu).

⁸⁴ *Kononov v. Latvia Judgment*, para. 185; *Korbely v. Hungary Judgment*, para. 70; GJEDNJ, *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina*, no. 51552/10, Decision, 10 April 2012 (“*Šimšić v. Bosnia and Herzegovina Decision*”), para. 23. Shih edhe *Ieng Sary Apeli Decision*, para. 213 (në të cilin Dhoma e Procedurës Paraprake e DHJGJK-së vendosi se parimi ndërkombëtar i ligjshmërisë e lejon përgjegjësinë penale mbi krimet që janë me natyrë kombëtare ose ndërkombëtare në kohën e kryerjes).

⁸⁵ Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen Thaçi dhe të tjerët, para. 37; nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 20 (ku Shala parashtron se neni 33 i Kushtetutës së Kosovës duhet interpretuar në përputhje me nenin 7 të KEDNJ-së).

krime lufte ose krime kundër njerëzimit janë të ndëshkueshme.⁸⁶ Paneli mendon se kjo gjuhë nuk do t'i shërbente asnjë qëllimi nëse nuk do të kishte pasur për synim të mbulonte çështje gjyqësore para përfshirjes së këtyre krimeve në legjislacionin e kodifikuar të Kosovës.⁸⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës të cilit i referohet Shala në mbështetje të argumentit se veprat penale duhet të jenë të përfshira në legjislacionin vendor në kohën e kryerjes së tyre, siç konstatohet më lart nga Paneli, nuk ka lidhje me Dhomat e Specializuara, duke qenë se ai ka të bëjë me një kornizë të ndryshme kushtetuese.⁸⁸

27. Shala argumenton më tej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i mbështet gabimisht në një “burim të vetëm” në mbështetje të interpretimit të tij se nuk ka shkelje të nenit 7(1) të KEDNJ-së në rastet e shpalljes fajtor në bazë të legjislacionit vendor jo në fuqi gjatë periudhës përkatëse, me kusht që të mbështetet në të drejtën konvencionale ndërkombëtare ose në DZN-në e zbatueshme në atë kohë.⁸⁹ Paneli vëren se, në dallim nga argumentet e Shalës, paragrafi i cituar nuk është “paragraf hyrës që i paraprin shqyrtimit të GJEDNJ-së”, por bën pjesë në vlerësimin e Gjykatës ku qartazi nuk përjashtojë mundësia që shpallja fajtor për gjenocid në një rast të tillë nuk do ta shkelte nenin 7 të KEDNJ-së nëse do të mbështetet në të drejtën ndërkombëtare në fuqi në kohën përkatëse.⁹⁰ Sidoqoftë, këto përfundime janë në

⁸⁶ Jo thjesht “e drejta ndërkombëtare e përgjithshme”, por krimet ndërkombëtare themelore që bëjnë pjesë në DZN-së, janë gjithsesi detyruese. Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 23, 37.

⁸⁷ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 39.

⁸⁸ Shih më lart, para. 20. Contra Apeli, para. 15, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 83 ku citohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 7 shtator 2004, f. 18.

⁸⁹ Apeli, para. 17, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 86 ku citohet GJEDNJ, *Vasiliauskas v. Lithuania*, no. 35343/05, Judgment, 20 October 2015 (“*Vasiliauskas v. Lithuania* Judgment”), para. 166.

⁹⁰ *Vasiliauskas v. Lithuania* Judgment, para. 166. Në këtë çështje gjyqësore, GJEDNJ-ja konstatoi se nuk kishte asnjë dispozitë ligjore në fuqi në kohën e kryerjes së veprës dhe se, për rrjedhojë, këto dispozita u zbatuan me fuqi prapavepruese, por nuk e karakterizoi këtë si përjashtim nga neni 7 i GJEDNJ-së. Gjithashtu, arsyeja përse GJEDNJ-ja konstatoi se shpallja fajtor e parashtruesit për gjenocid nuk mund të ishte parashikuar sepse “nuk ishte menjëherë e dukshme se kuptimi i zakonshëm i termave “kombëtar” ose “etnik” në Konventën për Gjenocidin mund të mbulonte edhe partizanët.” Shih *Vasiliauskas v. Lithuania* Judgment, para. 179-186. Contra Apeli, para. 17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake iu referua edhe një rasti të dytë në mbështetje të konstatimit të vet, siç e pranon edhe vetë

përputhje me jurisprudencë të mëtejshme të GJEDNJ-së e cila nuk ka konstatuar shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së në rastet kur të akuzuarit janë shpallur fajtorë nga gjykatat shtetërore për vepra të cilat cilësoheshin si vepër penale vetëm nga e drejta ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprës dhe janë përfshirë më vonë në legjislacionin e kodifikuar vendor që ka shërbyer si bazë për shpalljen fajtor.⁹¹ Paneli nuk bindet nga orvatja e Shalës për t'i dalluar konstatimet e disa prej këtyre aktgjykimeve nga çështja gjyqësore në fjalë.⁹² Paneli vëren gjithashtu se kriteret e disponueshmërisë dhe parashikueshmërisë në kuadër të parimit të ligjshmërisë vlerësohen rast pas rasti në lidhje me krime dhe forma konkrete të përgjegjësisë penale.⁹³

28. Gjithashtu, Paneli mendon se asnjë prej aktgjykimeve të cituara nuk e mbështet argumentin e Shalës se jurisprudenca e GJEDNJ-së e lejon ndjekjen penale në bazë të së drejtës ndërkombëtare, pa përfshirjen në legjislacionin vendor në kohën përkatëse, vetëm në lidhje me sjelljen “e paligjshme në mënyrë flagrante”, karakteri penal i së cilës është “dukshëm” i disponueshëm dhe i parashikueshëm për të akuzuarin.⁹⁴ Në

Shala. Shih Apelin, para. 18, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 86, ku citohet *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina* Decision, para. 22-25. Shih edhe më lart, poshtëshënimin 79.

⁹¹ GJEDNJ, *Penart v. Estonia*, no. 14685/04, Decision, 24 January 2006, f. 10 (ku GJEDNJ-ja vendosi se nuk ka shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së, edhe nëse veprimet e paditësit mund të ishin konsideruar si të ligjshme sipas të drejtës sovjetike të zbatueshme në kohën e kryerjes së veprimeve, duke qenë se është konstatuar se përbëjnë krime kundër njerëzimit në bazë të së drejtës ndërkombëtare në kohën e kryerjes, nga gjykatat e Estonisë pas rritimit të pavarësisë nga ana e saj); *Kononov v. Latvia* Judgment, para. 237-244. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 24, 37, ku i referohet edhe nenit 33(1) të Kushtetutës së Kosovës; *Ieng Sary* Appeal Decision, para. 213 (ku Dhoma e Procedurës Paraprake vendosi se “ndërsa parimi ndërkombëtar i ligjshmërisë nuk kërkon që, për të shpallur fajtor shkelësit, krimet ndërkombëtare dhe format e përgjegjësisë të vihen në zbatim me ligje vendore, karakterizimi i sistemit juridik kamboxhian si monist apo dualist nuk ka ndikim për vlefshmërinë e së drejtës së zbatueshme para DHJGJK-së”).

⁹² Shih Kundërpërgjigjen, poshtëshënimi 21, ku i referohet *Kononov v. Latvia* Judgment, *Korbely v. Hungary* Judgment. Në të dyja rastet, GJEDNJ-ja pranon se, për të përmbushur kriteret e nenit 7 të KEDNJ-së do të mjaftonte njohja e një vepre si krim në të drejtën ndërkombëtare.

⁹³ Shih më poshtë, pjesa IV (B), (C).

⁹⁴ Apeli, para. 16; Kundërpërgjigjja, para. 24, ku i referohet GJEDNJ, *Streletz, Kessler and Krenz v. Germany*, nos. 34044/96, 35532/97, 44801/98, Judgment, 22 March 2001 (“*Streletz et al. v. Germany* Judgment”), para. 85, 87; GJEDNJ, *K.H.W. v Germany*, no. 37201/97, Judgment, 22 March 2001 (“*K.H.W. v Germany* Judgment”), para. 75; GJEDNJ, *Polednová v. the Czech Republic*, no. 2615/10, Decision, 21 June

vend që të kërkonte që sjellja “e paligjshme në mënyrë flagrante” të lejojë ndjekjen penale në bazë të së drejtës ndërkombëtare, GJEDNJ-ja në këto çështje gjyqësore thjesht konstatoi që sjellja “e paligjshme në mënyrë flagrante” e të akuzuarit duhej ta ketë bërë karakterin e saj penal të parashikueshëm në kuptim të nenit 7(1) të KEDNJ-së.⁹⁵

29. Sa i takon pretendimit të Shalës se interpretimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake ishte “palejueshmërisht teleologjik” dhe se, si i tillë, shkel drejtësinë e procesit penal sipas neneve 6 dhe 7 të KEDNJ-së,⁹⁶ Paneli gjykon se Shala nuk shpjegon se si shkelja e pretenduar e nenit 6 të KEDNJ-së ka shkaktuar cenim të tillë që të përbëjë gabim juridik që zhvlerëson Vendimin e Apeluar.⁹⁷ Gjithsesi, burimet e cituara nga Shala nuk i mbështesin argumentet e tij.⁹⁸

2011 (“*Polednová v. the Czech Republic Judgment*”); *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina Decision*, para. 23, 24. Shih edhe Apeli, para. 18.

⁹⁵ *Streletz et al. v. Germany Judgment*, para. 77-78, 87-89; *K.H.W. v Germany Judgment*, para. 75, 90-91; *Polednová v. the Czech Republic Judgment*, pp. 25-26; *Šimšić v. Bosnia and Herzegovina Decision*, para. 23-25.

⁹⁶ Apeli, para. 9, ku i referohet GJEDNJ, *Gregaćević v. Croatia*, no. 58331/09, Judgment, 10 October 2012 (“*Gregaćević v. Croatia Judgment*”), para. 49; GJEDNJ, *Negulescu v. Romania*, no. 11230/12, Judgment, 31 May 2021 (“*Negulescu v. Romania Judgment*”), para. 39-42; GJEDNJ, *S.W. v. The United Kingdom*, no. 20166/92, Judgment, 22 November 1995 (“*S.W. v. The United Kingdom Judgment*”), para. 36; GJEDNJ, *G.I.E.M. S.R.L. a.o. v. Italy*, nos. 1828/06, 34163/07 and 19029/11, Judgment, 28 June 2018 (“*G.I.E.M. S.R.L. a.o. v. Italy Judgment*”), para. 251-261; GJEDNJ, *Jorgic v. Germany*, no. 74613/01, Judgment, 12 [October] 2007 (“*Jorgic v. Germany Judgment*”), para. 109-113. Shih edhe Apeli, para. 15, 25.

⁹⁷ Shih KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021, para. 44.

⁹⁸ Shih *Gregaćević v. Croatia Judgment*, para. 29, 49 (ku GJEDNJ-ja shqyrtoi nëse i akuzuari kishte kohë dhe mjete të mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e tij në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së në lidhje me revokimin e pezullimit të dënimit të tij); *Negulescu v. Romania Judgment*, para. 39-42 (ku konstatohet se garancitë procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së zbatohen edhe në lidhje me veprime të konsideruara si jokriminale në të drejtën vendore); *S.W. v. The United Kingdom Judgment*, para. 36 (ku konstatohet se sqarimi gradual i ligjeve penale lejohet sipas nenit 7 të KEDNJ-së nëse përputhet me thelbin e veprës penale dhe nëse mund të ishte logjikisht e parashikueshme); *G.I.E.M. S.R.L. a.o. v. Italy Judgment*, para. 251-261 (ku konstatohet se, kur janë vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm por procesi është pushuar vetëm për shkak të afateve të parashkrimit, ato konstatime mund të konsiderohen në thelb si shpallje fajtor në kuptim të nenit 7 të KEDNJ-së dhe mundësojnë zbatimin e masave të konfiskimit në mungesë të një vendimi zyrtar për shpallje fajtor të pronarit të pronës); *Jorgic v. Germany Judgment*, para. 109-113 (ku konstatohet se edhe një përkufizim më i gjerë i gjenocidit se përkufizimi i mbështetur nga disa burime mund të ishte logjikisht i parashikueshëm për të akuzuarin). Shih edhe Përgjigjen, poshtëshënimi 38.

30. Fakti se Dhomat e Specializuara veprojnë në bazë të Kushtetutës ekzistuese në fuqi në Kosovë nuk do të thotë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i detyruar të merrej me vlerësimin se cila kornizë ligjore është më e favorshme. Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka rrëzuar argumentet e Shalës në këtë aspekt *in limine* sepse u ngritën për herë të parë në kundërpërgjigje.⁹⁹ Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se, sipas rregullës 76 të Rregullores, kundërpërgjigja merret në konsideratë vetëm për pika që rrjedhin nga përgjigja.¹⁰⁰ Duke pasur parasysh se aspekti i *lex mitior* nuk ishte ngritur nga Shala në Mocionin Paraprak, as nga ZPS-ja në Përgjigjen ndaj Mocionit Paraprak, Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi në rrëzimin *in limine* të argumenteve të Shalës në këtë aspekt.¹⁰¹ Gjithsesi, parimi *lex mitior* ka të bëjë me një krahasim mes legjislacioneve penale,¹⁰² dhe, siç ka vendosur më parë Paneli, kundërshtimet konkrete ndaj të drejtës penale në fuqi nuk përbëjnë kundërshtime juridiksionale.¹⁰³ Paneli vëren se, në bazë të kësaj dhe duke pasur parasysh se DZN-ja është detyruese për të gjitha shtetet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e kishte për detyrim të krahasonte parimet e ligjshmërisë midis dy Kushtetutave.¹⁰⁴

31. Mbështetur në sa më lart, Paneli konstaton se Shala nuk ka demonstruar që Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se parësia e DZN-së e njohur në Ligj nuk e shkel parimin e ligjshmërisë. Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës së Apelit e rrëzon pjesën tjetër të Pikës (i) dhe Pikën (ii) të Apelit të Shalës.

⁹⁹ Vendimi i Apeluar, para. 81.

¹⁰⁰ Vendimi i Apeluar, para. 81.

¹⁰¹ *Contra* Kundërpërgjigja, poshtëshënimi 11.

¹⁰² Shih ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Nikolić*, IT-94-2-A, Judgment on Sentencing Apeli, 4 February 2005, para. 80; GJEDNJ, *Del Rio Prada v. Spain*, no. 42750/09, Judgment, 21 October 2013, para. 116; *Vasiliauskas v. Lithuania* Judgment, para. 154; GJEDNJ, *Kokkinakis v. Greece*, no. 14307/88, Judgment, 25 May 1993, para. 52.

¹⁰³ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 52-59.

¹⁰⁴ *Contra* Apeli, para. 11. Shih më lart, para. 20. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 25.

B. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME NDËRMARRJEN KRIMINALE TË PËRBASHKËT
(PIKA (III))

1. Parashtrimet e palëve

32. Në pikën e tretë të apelit, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se përgjegjësia për formën e parë dhe formën e tretë të NKP-së përfshihet në nenin 16(1)(a) të Ligjit.¹⁰⁵ Shala argumenton se Ligji nuk përcakton shprehimisht përgjegjësinë për NKP-në dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që mohoi statusin e diskutueshëm të NKP-së dhe pasojat e saj për “cilësinë e legjislacionit të zbatueshëm” si edhe për përputhshmërinë e NKP-së me kriteret e parashikueshmërisë dhe disponueshmërisë.¹⁰⁶ Sipas Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi edhe që konstatoi se NKP-ja, në veçanti forma e tretë e saj, përcaktohet qartë në DZN në kohën që ka lidhje me akuzat, pa marrë në konsideratë parashtrimet e Mbrojtjes, vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, DHJGJK-së dhe Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe (“UK”), si edhe mendimet akademike.¹⁰⁷ Gjithashtu, Shala argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se NKP III është në përputhje me parimin e fajësisë individuale.¹⁰⁸

33. ZPS-ja përgjigjet se Vendimi i Apeluar jep arsyetim të mjaftueshëm dhe konfirmon shprehimisht se neni 16(1) i Ligjit duhet interpretuar në kontekst të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara, duke mbajtur parasysh kontekstin, objektin dhe qëllimin e Ligjit dhe në përputhje me interpretimin që i bëjnë NKP-së gjykatat ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara.¹⁰⁹ ZPS-ja argumenton më tej se NKP III, krahas NKP I, ka qenë pjesë e DZN-së gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe është në përputhje me parimin e fajësisë individuale.¹¹⁰ Sipas ZPS-

¹⁰⁵ Apeli, para. 4(iii), 20-22. Shih edhe Apelin, para. 25.

¹⁰⁶ Apeli, para. 20, 22. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 29, 31.

¹⁰⁷ Apeli, para. 20-22.

¹⁰⁸ Apeli, para. 22.

¹⁰⁹ Përgjigjja, para. 30-34. Shih edhe Përgjigjen, para. 39.

¹¹⁰ Përgjigjja, para. 35-41.

së, i akuzuari shtrembëron Vendimin e Apeluar dhe nuk demonstroi asnjë gabim nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me përfundimin sa i takon statusit të NKP III në DZN.¹¹¹

34. Shala kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk u jep përgjigje argumenteve të tij që kundërshtojnë interpretimin dhe zbatimin që i bën Gjykatësi i Procedurës Paraprake nenit 16(1)(a) të Ligjit, por vetëm përsërit konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹¹² Sipas Shalës, mungesa e përfshirjes shprehimisht të NKP-së në Ligj pavarësisht nga fakti se u miratua kur hartuesit e Ligjit ishin të vetëdijshëm për jurisprudencën e diskutueshme mbi NKP-në tregon zgjedhjen e ndërgjegjshme të tyre për të mos e përfshirë.¹¹³ Ky interpretim, sipas Shalës, kërkohet nga neni 7 i KEDNJ-së dhe nenet 33 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës.¹¹⁴

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

35. Paneli vëren se Shala kundërshton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se përgjegjësia sipas formës së parë dhe të tretë të NKP-së përfshihet në nenin 16(1)(a) të Ligjit për arsye se Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet gabimisht në DZN dhe mohoi statusin e diskutueshëm të NKP-së, përfshirë edhe përputhshmërinë e saj me kriteret e parashikueshmërisë dhe disponueshmërisë.¹¹⁵ Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se neni 16(1) i Ligjit duhet interpretuar në përputhje me DZN-në e zbatueshme në kohën e krimeve të pretenduara, sepse: (i) në Dhomat e Specializuara DZN-ja ka përparësi mbi legjislacionin vendor; (ii) nenet 13-14 të Ligjit, në bazë të të cilave ngrihen akuzat kundër të akuzuarit, i referohen konkretisht DZN-së; dhe (iii) terminologjia e nenit 16(1) të Ligjit është thujse identike me dispozitat përkatëse të tribunalëve *ad hoc*.¹¹⁶

¹¹¹ Përgjigjja, para. 29, 35, 42.

¹¹² Kundërpërgjigjja, para. 27-29.

¹¹³ Kundërpërgjigjja, para. 29.

¹¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 30.

¹¹⁵ Apeli, para. 20, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 91.

¹¹⁶ Vendimi i Apeluar, para. 91.

Paneli pajtohet me këtë përfundim dhe rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se është bindur se Ligji e përcakton NKP-në si formë të përgjegjesisë penale.¹¹⁷ Në këtë aspekt, Paneli gjykon se, ndër të tjera, është mbështetur në jurisprudencën e gjykatave të tjera, përfshirë TPNJ-në dhe TPNR-në, për të trajtuar rastet kur Ligjit i mungon shtjellimi ligjor për pika konkrete dhe se NKP-ja është zbatuar përgjithësisht për krimet themelore brenda juridiksionit të këtyre gjykatave si formë e kryerjes në bazë të DZN-së.¹¹⁸

36. Paneli do të shqyrtojë tani parashtrimet e Shalës nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboji që konstatoi se NKP-ja përfshihej në DZN në periudhën përkatëse dhe se ishte e parashikueshme dhe e disponueshme për të akuzuarin. Paneli vëren se, në kundërshtim me argumentet e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e mori si të mirëqenë se NKP-ja ishte e parashikueshme dhe e disponueshme për të akuzuarin, por mori parasysh një sërë faktorësh, përfshirë kornizën përkatëse ligjore të zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore, faktin se aktgjykimi i parë i TPNJ-së që vuri në dukje përgjegjësinë për NKP ishte lëshuar në dhjetor 1998 dhe faktin se nenet 22 dhe 26 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 pasqyronin konceptin e përgjegjesisë penale të përbashkët.¹¹⁹ Paneli rikujton konstatimin e vet, ndër të tjera në bazë të të njëjtave argumente, se NKP-ja, në formën e saj të parë dhe të tretë, ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuar të tjerë në kohën e kryerjes së saj.¹²⁰ Sipas mendimit të Panelit, vendimi i Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe në një çështje gjyqësore që ka të bëjë me një vepër penale vendore sipas përgjegjesisë

¹¹⁷ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 136-138, 140.

¹¹⁸ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 136-138. Shih edhe Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 139 (konstatimi se në bazë të kuptimit të zakonshëm të nenit 16(1)(a) të Ligjit si *lex specialis*, NKP-ja përfshihet në termin “kryer”).

¹¹⁹ Shih Vendimin e Apeluar, para. 95. Contra Apeli, para. 20, 22.

¹²⁰ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 211-214, 218-224.

penale dytësore në bazë të së drejtës vendore nuk mund ta ndryshojë këtë përfundim.¹²¹

37. Sa i takon statusit të NKP-së në DZN, Paneli rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se NKP-ja, edhe në formën e parë edhe në formën e tretë, është formë përgjegjësie sipas DZN-së, përfshirë në kohën e kryerjes së krimeve të pretenduara.¹²² Paneli gjykon se parashtrimi i Shalës se Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi t'i merrte parasysh argumentet e tij lidhur me statusin e NKP III në DZN ngaqë nuk akuzohet për torturë e shtrembëron Vendimin e Apeluar.¹²³ Lidhur me këtë, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzoi të merrte parasysh vetëm argumentet e Shalës në lidhje me jurisprudencën e Tribunalit Special të Libanit dhe Gjykatës Speciale për Sierra Leonen sa i takon zbatimit të NKP III për krimet me synim konkret, sepse Shala nuk akuzohet për krime me synim konkret.¹²⁴ Në kundërshtim me argumentet e Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i mori parasysh argumentet e tij se jurisprudenca e DHJGJK-së dhe e Gjykatës Supreme të Britanisë së Madhe, si edhe mendimet akademike tregojnë se NKP III nuk i përmbush standardet e nenit 7 të KEDNJ-së.¹²⁵ Paneli konstaton se nuk ka asnjë gabim në vlerësimin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake u bën këtyre burimeve.¹²⁶

38. Gjithashtu, Paneli vëren se Shala nuk e mbështet me fakte argumentin e vet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur i gjykoi si jorelevante vendimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në të cilat u bazua Shala për të mbështetur

¹²¹ Shih Vendimin e Apeluar, para. 93. Contra Apeli, para. 20, ku i referohet UK, Supreme Cour, *Jogee v. The Queen* [2016] UKSC 8 dhe *Ruddock v. the Queen* [2016] UKPC 7, Judgment, 18 February 2016, para. 81.

¹²² Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 172, 196.

¹²³ Apeli, para. 21, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 93.

¹²⁴ Shih Vendimin e Apeluar, para. 93.

¹²⁵ Shih Vendimin e Apeluar, para. 93. Contra Apeli, para. 22.

¹²⁶ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 153, 187, 190-193 (sa i takon shmangies së DHJGJK-së lidhur me NKP III), 169 (sa i takon rolit të shkrimeve akademike në përcaktimin e DZN-së). Shih më lart, para. 36 (sa i takon rolit të vendimit të Gjykatës Supreme të Britanisë së madhe në përcaktimin e statusit të NKP-së në DZN).

argumentin e vet se NKP-ja ishte e pazbatueshme.¹²⁷ Gjithsesi, Paneli nuk konstaton gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se këto vendime të Gjykatës së Apelit të Kosovës u miratuan në përputhje me një kornizë ligjore të ndryshme.¹²⁸ Gjithashtu, Paneli vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar në disa raste se të gjitha format e përgjegjesisë penale të NKP-së janë “përcaktuar qartë” në DZN.¹²⁹

39. Sa i takon përputhshmërisë së NKP III me parimin e fajësisë individuale, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ky nuk është aspekt tërësisht juridiksional dhe se, gjithsesi, argumentet e Shalës janë të pathemelta.¹³⁰ Paneli vëren se Shala vetëm se përsërit në apel argumentet e parashtruara më parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹³¹ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Shala nuk artikulon asnjë gabim të qartë të kryer nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjatë trajtimit të këtyre argumenteve dhe i rrëzon ato menjëherë.¹³²

¹²⁷ Apeli, para. 21, ku i referohet Vendimit të Apeluar, para. 90, ku i referohet Mocionit Paraprak, para. 28 ku citohet Kosovë, Gjykata e Apelit, “J.D. dhe të tjerët”, PAKR Nr 455/15, Aktgjykim, 15 shtator 2016, f. 45; Kosovë, Gjykata Themelore e Mitrovicës (EULEX), çështja kundër XH. K, P 184/2015, Aktgjykim, 8 gusht 2016 (“Aktgjykimi i Gjykatës Themelore i datës 8 gusht 2016”), para. 82-88; Kosovë, Gjykata e Apelit (EULEX), çështja kundër XH. K, PAKR 648/16, 22 qershor 2017 (“Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 22 qershor 2017”), f. 10. Paneli vëren se në aktgjykimin e cituar në fund, Gjykata e Apelit e Kosovës pranonte se “ka argumente pro zbatimit të drejtëpërdrejtë të konceptit të NKP-së në të gjitha format e saj në çështjet gjyqësore të krimeve të luftës të kryera gjatë luftës së Kosovës” dhe konstatonte se NKP II ishte e zbatueshme dhe se NKP III nuk zbatohet sepse interpretimi i bashkëkryerjes sipas nenit 22 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976, që ishte baza për akuzat në atë çështje gjyqësore, nuk mund të përfshinin NKP III. Shih Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës i datës 22 qershor 2017, f. 10, ku i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të datës 8 gusht 2016, para. 87-88, 138.

¹²⁸ Shih Vendimin e Apeluar, para. 90.

¹²⁹ Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 193, 223, ku i referohet Kosovë, Gjykata Supreme, “L. G. dhe të tjerët” (njihet edhe si çështja e Grupit të Llapit), APKZ 89/2010, Aktgjykim, 26 janar 2011, para. 114-115 (rigjykimi i parë). Këto konstatime janë mbështetur në rigjykimin e dytë. Shih Kosovë, Gjykata Supreme, “L.G. dhe të tjerët”, Plm Kzz 18/2016, Aktgjykim, 13 maj 2016, para. 69 (rigjykimi i dytë). Shih edhe Kosovë, Gjykata Supreme, “E.K dhe S.B.”, PAII 3/2014, Aktgjykim, 7 gusht 2014, para. xli-xlii; Kosovë, Gjykata Supreme, “S.K. dhe të tjerët”, Ap.-Kz Nr 371/2008, Aktgjykim, 10 prill 2009, f. 14-16, 63-64.

¹³⁰ Shih Vendimin e Apeluar, para. 94.

¹³¹ *Krahaso* Mocionin Paraprak, para. 24 me Apelin, para. 22.

¹³² Shih, p.sh., KSC-BC-2020-06, F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial

40. Mbështetur në sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Shala nuk ka treguar që Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se NKP-ja përfshihet në nenin 16(1) të Ligjit dhe, rrjedhimisht, e rrëzon Pikën (iii) të Apelit të Shalës.

C. PRETENDIMET PËR GABIME LIDHUR ME JURIDIKSIONIN LËNDOR MBI NDALIMIN ARBITRAR (PIKA (IV))

1. Parashtrimet e palëve

41. Në pikën e katërt të apelit, Shala parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se ndalimi arbitrar në konfliktin e armatosur jondërkombëtar ishte “përfshirë saktë në akuzë”.¹³³ Sipas Shalës, interpretimi që i bën Gjykatësi i Procedurës Paraprake nenit 14(1)(c) të Ligjit në mënyrë joshteruese shkel parimin e sigurisë juridike dhe është “i gabuar në themel”, dhe përfundimi i tij se ndalimi arbitrar ishte i parashikueshëm mjaftueshëm për Shalën është “qartazi i paarsyeshëm”.¹³⁴ Shala parashtron gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk dha arsyetim të mjaftueshëm kur rrëzoi argumentet e tij në këtë aspekt.¹³⁵

42. ZPS-ja përgjigjet se parashtrimet e të akuzuarit duhen rrëzuar sepse janë “të përcipta dhe deklarative në atë shkallë që është qartazi e papërshtatshme”.¹³⁶ ZPS-ja argumenton më tej se këto argumente nuk janë të pathemelta, sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi saktë se ndalimi arbitrar nuk përputhet me kushtin e trajtimit çnjerëzor dhe përbën shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, përfshirë nenin 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 (“Neni i Përbashkët 3”).¹³⁷ Sipas ZPS-së, interpretimi i këtij krimi si i përfshirë në nenin 14(1) të Ligjit nuk prek parimin e sigurisë juridike, sepse

u dorëzua më 30 prill 2021), para. 60; KSC-BC-2020-07, F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit në lidhje me Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021, para. 15.

¹³³ Apeli, para. 4(iv), 23-25.

¹³⁴ Apeli, para. 23; Kundërpërgjigjja, para. 32-34.

¹³⁵ Apeli, para. 23.

¹³⁶ Përgjigjja, para. 43.

¹³⁷ Përgjigjja, para. 43-47, 49, 52.

fushëveprimi i kësaj dispozite është gjithsesi i lidhur me shkeljet e rënda të nenit të përbashkët 3 dhe veprat penale që kanë ekzistuar në bazë të DZN-së në kohën kur pretendohet se janë kryer.¹³⁸ Në fund, ZPS-ja parashtron se ekzistenca e një norme të DZN-së e cila e penalizonte ndalimin arbitrar, ishte e disponueshme dhe e parashikueshme për të akuzuarin.¹³⁹

43. Shala kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk arrin të justifikojë shmangien e Gjykatësit të Procedurës Paraprake nga precedenti detyrues i Gjykatës Supreme të Kosovës e cila i ka shfuqizuar akuzat për ndalim arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar dhe nuk merr në konsideratë se, në kohën që ka lidhje me akuzat, ky krim, as nuk përcaktohej si vepër penale, as nuk konsiderohej si shkelje e nenit të përbashkët 3.¹⁴⁰

2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

44. Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se formulimi “duke i përfshirë veprat në vijim” i nenit 14(1)(c) të Ligjit do të thotë se kjo listë është joshteruese dhe se juridiksioni i Dhomave të Specializuara nuk përfshin vetëm veprat e renditura shprehimisht në nenin 14(1)(c) të Ligjit.¹⁴¹ Duke pasur parasysh se, që një vepër të përfshihet në Ligj dhe, rrjedhimisht, në juridiksionin e Dhomave të Specializuara, ajo duhet të ketë ekzistuar në DZN gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara dhe duhet të përbëjë një shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët, Paneli konstaton se gjuha joshteruese e Ligjit nuk e shkel parimin e qartësisë juridike. Paneli vëren se Shala nuk e mbështet me fakte argumentin e tij se interpretimi që i bën Gjykatësi i Procedurës Paraprake nenit 14(1)(c) të Ligjit mund të jetë i gabuar për ndonjë arsye tjetër.

¹³⁸ Përgjigjja, para. 44, 49.

¹³⁹ Përgjigjja, para. 48, 50-51.

¹⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 32-34.

¹⁴¹ Vendimi i Apeluar, para. 98. Shih edhe Vendimin e Konfirmimit, para. 23. Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 87.

45. Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 dhe se është pasqyruar fuqimisht në formulimin e nenit të përbashkët 3, që bën pjesë në DZN.¹⁴² Në këtë aspekt, Paneli rikujton se ndalimi bëhet arbitrar dhe përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 kur shkelet parimi i trajtimit njerëzor, pavarësisht nëse ndalimi ka bazë ligjore.¹⁴³

46. Gjithashtu, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) konfirmoi në mënyrë të pavarur ekzistencën e një rregulle të DZN-së e cila e penalizonte si krim ndalimin arbitrar në konfliktin e armatosur jondërkombëtar në kohën që lidhet me akuzat;¹⁴⁴ dhe (ii) duke pasur parasysh se në bazë të statusit që ka në DZN ndalimi arbitrar, penalizimi si krim i heqjes arbitrare të lirisë në ish-Jugosllavi dhe dënimi i një sjelljeje të tillë nga OKB-ja në lidhje me konfliktet në ish-Jugosllavi, ishin të disponueshme dhe të parashikueshme për të akuzuarin se në kohën përkatëse, përfshirja në veprime të ndalimit arbitrar mund të rezultonte në përgjegjësi penale individuale.¹⁴⁵ Paneli rikujton se pajtohet me këto përfundime.¹⁴⁶ Rrjedhimisht, Paneli konstaton se akuzat për ndalim arbitrar në konflikt të armatosur jondërkombëtar në këtë rast nuk e shkelin parimin e ligjshmërisë. Gjithashtu, Paneli konstaton se Shala nuk i ka mbështetur me fakte argumentet e veta se përfundimi i nxjerrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar ishte mjaftueshëm i parashikueshëm për të akuzuarin në kohën që lidhet me akuzat është “qartazi i paarsyeshëm” në një mënyrë që do ta bindte

¹⁴² Vendimi i Apeluar, para. 100.

¹⁴³ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 95-97.

¹⁴⁴ Vendimi i Apeluar, para. 101.

¹⁴⁵ Vendimi i Apeluar, para. 102.

¹⁴⁶ Vendimi i Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 106-109, 111 (ku konstatohet, ndër të tjera, se: ndalimi arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar ekzistonte si krim lufte në DZN gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara; Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 përcaktonte asokohe shprehimisht veprën penale të arrestimit të paligjshëm si krim lufte pa bërë dallimin midis konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe atij ndërkombëtar; dhe rezolutat përkatëse të OKB-së konfirmojnë se një shkelje e tillë sjell pasoja sa i përket përgjegjësisë penale).

Panelin të mos pajtohej me këto përfundime.¹⁴⁷ Po kështu, Paneli nuk është në gjendje të identifikojë asnjë argument të ngritur nga Shala por që Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e trajtoi dhe, rrjedhimisht, konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm në këtë aspekt.¹⁴⁸

47. Mbështetur në sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se Shala nuk ka arritur të tregojë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që konstatoi se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi ndalimin arbitrar si krim lufte të kryer në një konflikt të armatosur jondërkombëtar sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe, rrjedhimisht, e rrëzon Pikën (iv) të Apelit të Shalës.

¹⁴⁷ Shih Apelin, para. 23; Kundërpërgjigjen, para. 33. Shih edhe Kundërpërgjigjen, para. 32, ku i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2005, f. 12. Shih më lart, para. 20 (ku Paneli ka konstatuar se ky, krahas aktgjykimeve të tjera sipas Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut, nuk ka lidhje me Dhomat e Specializuara, sepse ka të bëjë me një kornizë të ndryshme ligjore). Gjithashtu, një interpretim i thjeshtë i nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 dhe i dispozitave përkatëse në legjislacionet e tjera penale të vendeve të ish-Jugosllavisë tregon se këto dispozita përmendnin shprehimisht veprën penale të arrestimit të paligjshëm si krim lute pa bërë dallimin midis konfliktit të armatosur jondërkombëtar dhe atij ndërkombëtar. Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 107, ku i referohet Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976, neni 142; Slloveni, Kodi Penal (1994), neni 374(1); Republika e Maqedonisë së Veriut (1996), neni 404(1); Kroaci, Kodi Penal (1997), neni 158(1); Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kodi Penal (1998), neni 154(1).

¹⁴⁸ Shih Apelin, para. 23. Gjykatësi duhet së paku të japë arsyetim në mbështetje të konstatimeve mbi pikat materiale të lidhura me vendimin. Shih Vendimin e Apelit mbi Kundërshtimet Juridiksionale në Çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, para. 154, ku i referohet ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.4, Decision on Prosecution Apeli Following Trial Chamber's Decision on Remand and Further Certification, 11 May 2007, para. 25; TPNJ, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.4, Decision on Prosecution Apeli Concerning the Trial Chamber's Ruling Reducing Time for the Prosecution Case, 6 February 2007, para. 16.

V. VENDIM

48. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

RRËZON Apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E premte, 11 shkurt 2022

Në Hagë, Holandë